

VENDIM
Nr. 731, datë 24.10.2012

**PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË
SË MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT DETARE - AMFIBE
“ALBANIAN LION - 2012”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare - amfibe “Albanian Lion - 2012”, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

2. Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) trupave ushtarakë të Britanisë së Madhe.

3. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve joluftarake të evakuimit (NEO-Non-Combatant Evacuation Operations) nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije luftarake zbarkuese, helikopterë dhe forca speciale për veprimtaritë në tokë.

4. Stërvitja zhvillohet në periudhën 3-18 nëntor 2012, në rajonin e gjirit të Vlorës, në Gadishullin e Karaburunit, ishullin e Sazanit, bazën e Porto-Palermos dhe në bazën ajrore të Kuçovës.

5. Në këtë stërvitje angazhohen 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) trupa, 4 (katër) anije luftarake, 1 (një) helikoptermbajtës, 1 (një) fregatë e 2 (dy) anije zbarkuese dhe 11 (njëmbëdhjetë) helikopterë, të cilët do të kryejnë lëvizje gjatë 24 orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas pikës 4 të këtij vendimi. Në rajonin e Gadishullit të Karaburunit do të kryejnë veprimtari stërvitore 400 (katërqind) marinsa (forca speciale) të Forcave të Armatosura Mbretërore Britanike, të cilët do të simulojnë mbështetjen e operacionit nga toka.

6. Trupat britanikë gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009.

7. Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë trupat britanikë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha